

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/28/perplasja-per-rregullore-gjko-ne-kolaps-3-jave-pa-gjyqe/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:12:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:03:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	da712a075cd03b579630c186a352cbbc22d929c276da6d374f74e7511618fa63
TEKSTI	52fd655ae5563c07999074fe26b57959c4919ee959f6208208fddf9c6d5e56aa
PAMJA	6a656e9fa4137a2a33d12e5d414673a5fe8c11527af670d92f8cb5d0ec2f5d58

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84473d4994bf94f9d17c130acd2ea76fc3ff8e88722f6a3dec637772cc320774
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84473d4994bf94f9d17c130acd2ea76fc3ff8e88722f6a3dec637772cc320774>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe

Aktualitet

Publikuar: 28/09/2026



Gjkata e Posaçme është futur në një ngërç funksional. Prej tre javësh në të nuk është zhvilluar asnjë gjykim në themel. Proceset kanë dështuar për shkak të bojkotit të avokatëve, që kërkojnë rishikim të një rregulloreje të gjykatës. Nga e hëna, avokatët nisën bojkot edhe të seancave të masave të sigurimit.

Një rregullore e re e brendshme në Gjykatën e Posaçme, që nisi të zbatohet prej datës 1 shtator, po e çon këtë gjykatë në kolaps. Të hënën, radha e dështimit të gjyqit i ra mes të tjerëve dosjes "Partizani", kryebashkiakut të Shkodrës, apo edhe Emiliano Shullazit. Proceset në GJKKO, janë në ngërç prej 8 shtatorit, kur avokatët vendosën të bojkotojnë çdo gjykim në themel. Mes bojkotit mbrojtësit kërkojnë rishikim të rregullores, që sipas tyre, i kufizon në ushtrimin e profesionit të avokatit.

Për më shumë se dy javë, bojkoti i avokatëve u injorua nga Gjykata e Posaçme. Në disa seanca mbrojtësit u gjobiten nga gjykata me nga 10-50 mijë lekë me arsyetimin e mungesës së papërligjur.

Më 23 shtator avokatët përshkallëzuan revoltën, duke vendosur të bojkotojnë edhe seancat për caktimin, vlerësimin apo zëvendësimin e masave të sigurisë. Bojkoti total nisi nga e hëna. Në të njëjtin vendim, Dhoma e Avokatisë tërhoqi listën e avokatëve kryesisht nga Gjykata e Posaçme, duke e lënë thatë nga mbrojtësit. Kjo do të thotë, se nëse një i arrestuar nga SPAK shkon për masë sigurie në gjykatë, ai do të mbetet pa mbrojtje, duke ju mohuar kështu një e drejtë kushtetuese. Ditën e parë të bojkotit total nga avokatët në GJKKO nuk pati masa sigurie, ndërsa nuk është e qartë si do të veprohet prej saj në ditët në vijim. Për ironi, në të njëjtën godinë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit, që ka një tjetër rregullore, proceset vihojnë normalisht.

Me të lexuarat

-  Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys Agjencimit (Rajon) media e vëllezërve Veshaj që i blenë Fidel Yllit për 300 mijë euro, biznesmenia të patmenat e fjetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare Kumbaret e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 100 mijë drogë sigurie/ OpenAI nën hetim për agjentët e Inteligjencës Artificiale, anashkaluan fil...
- 
- 
- 
- 

E ndërsa avokatët kërkojnë rishikimin e rregullores dhe gjykata nga ana tjetër nuk bën hapa pas, të humburit e mëdhenj janë të pandehurit, që më së paku po ju zvarriten proceset gjyqësore. Për ata janë në masën e sigurisë “arrest në burg”, me apo pa faj, po ju zgjatet koha e qëndrimit në qeli. /A2

TAG:

Gjikko

kolaps

Përplasja për rregulloren

Të ngjashme



Erion Braçe shkon të vizitohet në QSUT dhe befasohet nga ministrja e re: Më pëlqejnë vendimet e saj



Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, Bamir Topi komenton arrestimin e kreut të SHISH: Kur ndodhi Gërdeci, unë zgjodha...



Kreu i komanduar i SHISH shfaqet për herë të parë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Elvis Lila me karrierë 20-vjeçare në shërbimin e inteligjencës

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

- KREU INVESTIGIM
- KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
- KRYESORE POLITIKË EKONOMI
- ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.